



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:2	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	23.04.2025 Ora: 10:15
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSBB-së
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojša Sekulliç, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;7. Svetlana Dorčić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Adnan Ramić, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dolica, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;16. Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendineta Shatri, EVSB;19. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Almina Eqo, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“;23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.

Mungojnë: Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame
Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,
Ganimet Shaqiri, Komuniteti Romë
Gjulla Karishik, Komiteti për Komunitete
Tog. Albestrim Rexhepi, FSK
Gëzim Ademaj, KLSP, Banjë
Armir Arifaj, SH.K.K Burgu i Dubraves
Komuniteti i Biznesit

Pjesëmarrës tjerë:

Bahrije Muqa, OSBE
Gjyldane Ahmeti, OSBE
Enver Dembogaj, AUV
Xhavit Demaj, Drejtorati i Inspektionit Istog
Endrit Mehmetaj, RTV Fontana
Mehmed Qeman, përkthyes, Komuna Istog
Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit, Komuna Istog
Lirije Demiri, Komuna Istog

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit
3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Sh.K.K "Burgu i Dubraves", Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduar, prodhim i pa kontrolluar
6. Problemet e infrastruktures që ndikojnë në siguri, në zonat urbane të minoriteteve
7. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Përsëndet të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të prënishmit. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Konstatohet se nga 24 anëtar të KKSB-së, të prënishëm janë 17 anëtar dhe kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës pos këtyre që i lajmroj. Me që nuk ka propozime tjera, miratohet rendi i ditës unanimitet.

2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pyet anëtarët e KKSBB-së të pranishëm në mbledhjen e kaluar a ka dikush vrejtje në ekstraktin e procesverbalit. Me që nuk ka vrejtje, miratohet ekstrakti i procesverbalit unanimisht.

Kalojm në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, fjalën ja kalon zv. komandantit të Policisë.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog - Situata në zonën e përgjegjesisë është e qet dhe stabile. Në vazhdim do të paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

- Rate të inicuar 165, kemi ngritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024
- 114 vepra (kundervajtje dhe penale) 103 në vitin 2024, kemi ngritje
- Zbulueshmerua e 70.8% e rasteve në përgjithësi
- Aksidente trafiku 48, ndërsa në vitin 2024 40, pra ka rritje, nga të cilat ime lëndime 16 ndërsa me dëme materiale 32
- Të lënduar 21 persona, ë vitin 2024 23 persona
- Kemi pas 42 asistime institucioneve të ndryshme
- Nga rastet sensitive kemi zjarrëvënjet në stane në bjeshkë dhe dhuna në familje.

Vlen të theksohet se stanet në bjeshkë nuk kanë leje ndertimi.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falënderoj komandantin e Policisë dhe hap debatin .

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- a është bërë ndonjë analizë cilët janë faktorët e dhunës në familje.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog -I kemi dy familje që i kanë të ngritura nga 3-4 raste dhe këto kryesisht ndikojnë në ngritjen e numrit të rasteve në Komunë. Arsyet i kanë prej më të ndryshmeve deri sa mund të thuhet edhe banale, por këto familje janë të njohura edhe për opinjonin publik.

Nga rastet sensitive rastin në Feliks e ka trajtuar Njësia e Krimeve të rëna dhe njëri nga të dyshuarit ka qenë në mbajtje për 48 orë ndërsa tjetri me vendim të Gjykatës në paraburgim për 30 ditë.

Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore - zyrtari Policor Fadfil Hoxha në takim që kemi mbajtur javën e kaluar, Mekanizmi kundër dhunës në familje i ka paraqit gjitha rastet, të ndara sipas gjinisë, etnis dhe moshës..

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -Mekanizmi kundër dhunës në familje ka mbajtur takim këtë tremujor dhe ka konstatuar se ka rritje të rasteve ndërsa arsyet janë nga më të ndryshmet.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqses të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës, Perfaqsesit e KFOR-it, FSK-së, Arsimit etj fjala është për ju.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë- pyetje per Drejtorin e DKA-së a ka test para testit PISA?

Naim Behluli, Drejtor i DKA-së- Shkollat ndermarrin masa pregaditore para testit por nuk ka test të organizuar. Mund të theksoj se Komuna e Istogut qendron shumë ma mirë sesa Komunitat tjera.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon perfaqsesin e FSK-së, me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës.

5. Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduar, prodhim i pa kontrolluar

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - ftoj Z. Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines (AUV), zyrja regjionale Pejë që ta paraqes një raport lidhur me gjendjen në lokalet afariste ushqimore, rrjedhimisht krahasimin e Komunës së Istogut me komunitat tjera ekuivalente.

Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines - Në kuader të zyrës regjionale veprojmë dy sektore ai i Veterines dhe ai i Sanitaris me nga dy Inspektor që është numër tejet i vogël për ta mbuluar regjionin e Pejës.

AUV ka për detyr krijimin e kushteve për ushqim të sigurt dhe për të përmbushur këtë detyrë AUV merr produkte ushqimore qoftë në Dogan apo në markete dhe i bën analizat, a i plotsojmë gjitha kriteret për treg. Këto i bën me kontrolla të rregullta apo bazuar në kërkesat dhe shqetsimet e konsumatorve në rate të veçanta. Kemi kryer inspektime në komunën e Istogut dhe ka raste kur kemi shqiptuar edhe denime në raste të skadimit të afateve të gjerave ushqimore. Mund të kostatojmë se gjendja në përgjithësi në Istog është e mirë megjithatë për ta konsumuar në përgjithësi këtu të është dashur të jetë edhe Inspektori Sanitar prezent sepse është përgjegjësi e tij a ka ndonjë produkt i cili shitet jashtëligjshëm apo që biznesi nuk e ka të drejtën ta shesë në veçanti për lokalet në afersi të Shkollave. Tani do ta kemi një problem në organizim me që Inspektori Sanitar ka kaluar në kuader të Ministrisë së Shëndetësisë.

Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- përditë në javë bëjmë inspektime të rregullta në thertoret e licencuara, gjithashtu inspektimet i bëjmë edhe në mishtore dhe në markete. Problem na paraqesin fshatrat për inspektime të rregullta a shesin produkte të mishit dhe a bëhet thërja sipas Ligjit. Fillimisht kaq nga ana ime jamë i hapur për pyetje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - i falenderoj inspektorët në raportin e paraqitur dhe hapim debatin lidhur me temën.

Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc- ka qenë një shqetsim medial lidhur me importin e mishit të pulës nga Brazili, a ka ndonjë informatë lidhur me veprimet e AUV-it për këtë çështje.

Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines - janë marrë mostrat e këtij produkti dhe nuk ka figuruar me ndonjë problem për të cilin do

të ndalohej konsumimi i këtij produkti. Kemi pas raste kur kemi ndaluar komplet importin për konsum.

Naïm Behluli, Drejtor i DKA-së- kërkoj që Inspektori sanitar të inspektoj lokalitetet dhe kiosqet në afersi të Shkollave dhe të konstatoj a shitën produkte ushqimore jashta licences, a shitën cigare me copë dhe të na informoj lidhur me këtë shqetsim të prindërve të nxënësve.

Enver Demibogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines -Planet janë që në kuadër të AUV-së të pranohen Inspektor të sigurisë ushqimore dhe shpresojm që së shpejti të kryhet ky proces.

Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- ka pasur raste kur kemi dal në inspektim së bashku me inspektorin e tregut dhe i njëjti ka shqiptu edhe denime për parregullsit në biznesin e inspektuar. Por ka një seri çështjesh që nuk janë kompetenc e këtij Inspektori por të atij Sanitar.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKSB-së - shqetsim i konsumatorve janë dy produkte në veçanti vezet dhe mishi i bluar a duhet të ket deklaracion të kohës së rruajtjes. Tek vezet në të shumtat e rasteve shihet një copë lëter e vogël e qitur mbi vezë e cila mund të ndrrohet sa her të doj pronari i biznesit e në të cilin konsumatori nuk ka siguri të bazohet, ndersa mishi i bluar nuk ka fare por kur konsumatori e hap në shtëpi i del gjys i nxirë.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - shihet qart nga diskutimet që një seri çështjesh janë të Inspektorit sanitar andaj për mbledhjen e radhes të ftohet Inspektori dhe të na jep përgjigje në shqetsimet e ngritura. Me që nuk ka më pyetje kalojm në pikën e radhes të rendit të ditës.

6. Problemet e infrastruktures që ndikojn në siguri, në zonat urbane të miniriteteve

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - ftoj shefin e ZLK-së që ta paraqes një raport lidhur me temën.

Rasim Mahmutoviq, Shef i ZLK-së- ZLK-ja punon sipas planit të kontakteve me përfaqsesit e komuniteteve. Bazuar në të dhënat nga përfaqsesit e komuniteteve situata e përgjithshme është e qet dhe stabile me disa probleme që koh pas kohe i shqetsojnë qytetarët por që nuk ndikojn në situatën e përgjithshme të sigurisë së komuniteteve.

Shqetsimi kryesor që ka qenë në kohët e më hershme viedhjet qoft të objekteve të banimit apo kafshëve në komunitete tani së fundmi nuk janë shqetsime me që ka përmirësime të dukshme. Kërkesat e komuniteteve të cilat mund të ndikojn pozitivisht në sigurinë e komuniteteve e që kanë të bëjnë me projekte janë:

- Ndertimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në Rr. Sarajevska si dhe shenjat horizontale, gjegjësisht pëngesat horizontale në rrugë.
- Rregullimi i rruges Serbobran-Osojan e cila ka gropa të mëdha dhe thejse është e pa kalueshme
- Deponit e mbeturinave në Llukavc të Begut

Ky është një raport i shkurtër dhe nese ka pyetje jam i hapur për përgjigje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës – falenderoj Rasimin në këtë raport të shkurtër por përmbajtsor dhe hapi debatin lidhur me temën. Me që nuk ka pyetje kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

7. Të ndryshme

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -pyet a ka dikush të ngris ndonjë çështje jashtë rendit të ditës. Me që nuk ka ju falenderoj në pjesmarrje dhe në kontributin e dhënë në këtë takim dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja perfundoj:

11.40